




REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Lidhja e Bizneseve të Kosovës
Business League of Kosovo
Povezivanje preduzeca na Kosovu

Pranuar / Primenë Me Data 10-01-2025			
Nr. I Organi Org. Broj	Numri Broj	Shtypje Printoj	Vlera Vrednost
02-	035/	02-	13



Komuna e Vitisë
Municipality of Vitina
Opština Vitina

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI

në mes të

LIDHJES SE BIZNESEVE TË KOSOVËS

dhe

KOMUNËS SË VITISË

VITI
2025

Lidhja e Bizneseve të Kosovës dhe Komuna e Vitisë, me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit afatgjatë, firmosin këtë:

Memorandum Mirëkuptimi

Neni 1

Palët , Lidhja e Bizneseve dhe Komuna e Vitisë, do të zhvillojnë forma e bashkëpunimit në fushëveprimin e vet.

Për këtë ata do të ndërtojnë lidhje të qëndrueshme në shkëmbimin e ekspertizës, përvojës dhe resurseve të përbashkëta në të mirë të zhvillimit ekonomik dhe turizmit të komunës së Vitisë.

Palët do të mbështesin projektet reciproke, do të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta dhe bashkarishtë do të realizojnë projekte nga fusha e këtij Memorandumi.

Palet gjithashtu do të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta me qëllim të vendosjes dhe zhvillimit të bashkëpunimit në të mirë të zhvillimit ekonomik të komunës.

Neni 2

Marrëveshja parasheh harmonizim të projekteve mes Lidhjes së Bizneseve të Kosovës dhe Komuna e Vitisë. E tërë kjo bëhet me qëllim të afrohen me njëra tjetrën dhe të inkurajohet bashkëpunimi ekonomike në të mirë të komunës dhe sektorit privat.

Neni 3

Ky Memorandum i Mirëkuptimit synon rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve në procesin e implementimit të qëllimeve të përbashkëta. Pra në bazë të partneritetit do të zhvillojnë bashkëpunimin në realizimin e Promovimit të prodhimeve vendore “Java e Biznesit Kosovar”, zhvillimit të projekteve ekonomike locale, Promovimit të bizneseve, investimeve të huaja, propozimeve lidhur me zhvillimin ekonomik lokal, zhvillimin e projekteve të përbashkëta në komunën e Vitisë.

Do të ofroj bashkëpunimin e mirëfilltë për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike që do të zhvillohen me Komunën e Vitisë , për promovimin e prodhimeve vendore , mbështetjen në fushën e bujqësisë, Turizmin dhe fushat tjera ekonomike në kuadrin të Komunës së Vitisë.

Do të ofroj bashkëpunim të mirëfilltë në zhvillimin e projekteve tjera me karakter ekonomik.

Do të mbaj takime të përbashkëta zyrtare, sipas nevojave të palëve në interes të komunës dhe zhvillimit ekonomik lokal dhe sektorit privat. Do të mbështet Komuna e Vitisë, projektet e përbashkëta në të mirë të komunës , sektorit privat dhe zhvillimit ekonomik.

Neni 4

Nënshkruesit të kësaj marrveshje janë nisur nga vullneti dhe marrëdhëniet për zhvillimin e ekonomik te vendit, bizneseve, respektivisht në mes të dy Istitucioneve, dhe rritjes të shkëmbimëve ne mes veti.

Neni 5

Nisur nga rëndësia që ka ekonomia në forcimin e këtyre marrëdhënieve, me dëshirën për të ofruar një model bashkëpunimi ne fushat perkatese ne interes të zhvillimit ekonomik dhe bizneseve të Komunës së Vitisë.

Neni 6

Nga ky memorandum, do përfitojnë sektori privat, prodhuesit vendos, turizmi malor i komunes si dhe duke sjelle investitor potencial te huaj ne Komunen e Vitisë

Memorandumi synon krijimin e një platforme për bashkëpunim të vazhdueshëm dhe konkret mes Komunës dhe komunitetit të biznesit, me fokus të veçantë në promovimin e prodhimeve vendore dhe turizmit, lehtësimin e procedurave administrative për bizneset, dhe përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm biznesor në Viti.

Objektivat kryesore të bashkëpunimit përfshijnë:- Promovimin e prodhimeve dhe shërbimeve vendore;- Lehtësimin e procedurave administrative për bizneset dhe përmirësimin e klimës së investimeve;- Avokimin e përbashkët për nisma ligjore që adresojnë sfidat e komunitetit të biznesit;- Promovimin e transparencës në proceset vendimmarrëse komunale;- Koordinimin në zhvillimin e politikave që stimulojnë rritjen ekonomike dhe tërheqjen e investimeve;- Angazhimin e bizneseve në adresimin dhe shqyrtimin e sfidave administrative dhe ligjore.

Ky Memorandum shënon një fillim të ri në angazhimet e përbashkëta për përmirësimin e mjedisit ekonomik dhe përkrahjen e bizneseve në Viti.

Komuna e Vitisë do t' mbeshtet projektet qe kane te bejne me mbeshtetjen e bizneseve ne Komunen e Vitisë, mbeshtetjen e prodhimeve vendore, mbeshtetjen ne iniciativat e investimeve te huaja, dhe projekte tjera qe ndikojne ne zhvillimin ekonomik të Komunes së Vitisë.

Komuna do mbeshtet Lidhjen e Bizneseve, sipas ligjeve në fuqi ne aktivitetet te cilat do organizohen ne Komunen e Vitisë, qe kane te bejne ne promovimin e prodhimeve , promovimin e sektorit bujqesore, vreshtari dhe turizmin si dhe mbeshtetjen e sektorit privat dhe zhvillimin ekonomik te Komunes.

Neni 7

Ky Memorandum i Mirëkuptimit do të fillon të *implementohet* me rastin e nënshkrimit nga dy palët e nënshkruar.

Ndryshimet ne të, apo nderprerja mund të behët me paralajmerim me shkrim në mës palëve, duke i shqyrtuar të gjitha komponentet për ndryshime apo për nderprerje.

Neni 8

Palët zotohen që do të kontribuojnë në fushën ekonomike të vendit, në të mirë të zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës.

Neni 9

Memorandumi është i përpiluar në dy ekzemplarë me përmbajtje të njëjtë, prej të cilave, pas nënshkrimit dhe protokolimit, nga një ekzemplar i dorëzohet për secilën palë.

Neni 10

Kjo marrëveshje është në gjuhën shqipe dhe është e përpiluar në dy kopje identike. Të gjitha kopjet kanë të njëjtën forcë ligjore dhe janë të vlefshme për të gjitha palët nënshkruese.

Neni 11

Ky Memorandum është lidhur me 10/01/ 2025, në pajtim me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës dhe statutit të dy institucioneve.

Nënshkruar në Viti,

Në emër të:
Lidhjes së Bizneseve të Kosovës

Besart Dreshaj-Kryetar

Në emër të:
Komunës së Vitisë

Sokol Haliti- Kryetar

